



Republika e Kosovës
Ministria e Shëndetësisë



Organization for Education, Science and Health

Organizata për Arsim, Shkencë dhe Shëndetësi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org Unit	06
Nr. Prot: Broj Prot: Prot No:	05-736
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-04-
Data: Datum: Date:	06,02,13
Prishtinë / a	

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
(MSH)

DHE

ORGANIZATËS PËR ARSIM, SHKENCË DHE SHËNDETËSI
(KISCOMS)



Republika e Kosovës
Ministria e Shëndetësisë



Organization for Education, Science and Health
Organizata për Arsim, Shkencë dhe Shëndetësi

Neni 1

Palët në rastin e nënshkrimit përfaqësohen nga:

- 1-Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës,(MSH) të cilën e përfaqëson Ministri i Shëndetësisë, Prof. Dr. Ferid Agani, adresa: Rr. Zagrebit p.n. Prishtinë.
- 2-Organizata për Arsim, Shkencë dhe Shëndetësi, (KISCOMS) të cilën e përfaqëson drejtori ekzekutiv, Dr. Xheladin Ujkani, Adresa: Rr.,Bill Klinton“ – Nr. 42, Lakrishtë-Dardani, Prishtinë.

Neni 2

Qëllimet

Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim realizimin e përbashkët të projekteve në fushën e edukimit shëndetësor, përkatësisht të projektit “Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur- Viti shkollor 2012-2013” në të gjitha Institucionet e arsimit fillore dhe të mesëm në Kosovë.

Ky projekt do të realizohet gjatë vitit shkollor 2012-2013, përkatësisht nga muaji shtator 2012, deri në muajin qershor 2013, në të gjitha Institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme të Republikës së Kosovës, bazuar në programin ”Shkollat Promovuese të Shëndetit” dhe në rekomandimet e grupit ndërministror nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) si dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS).

Në projektin “Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur- Viti shkollor 2012-2013”, do të përfshihen në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbi 1150 Institucione parashkollore, fillore dhe të mesme të Republikës së Kosovës, përkatësisht do të përfshihen një numër prej 450 mijë fëmijë-nxënës.

Programi ”Shkollat Promovuese të Shëndetit” është program i cili implementohet në dhjetëra shtete rajonale, evropiane dhe botërore. Në Republikën e Kosovës, ky program është inicuar nga OBSH nepërmjet një Memorandumi të bashkëpunimit me grupin ndërministrorë, (MASHT), (MSH), (MMPH) si dhe (MKRS), ndërsa është aprovuar nga Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 30 mars 2010.



Republika e Kosovës
Ministria e Shëndetësië



Organization for Education, Science and Health
Organizata për Arsim, Shkencë dhe Shëndetësi

Neni 3 **Fushat e bashkëpunimit**

1. Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim edukimin e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme mbi rëndësinë e mirëmbajtjes së higjienës orale;
- 2- Informimin e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme mbi metodën e drejtë dhe të rregullt të pastrimit të dhëmbëve, duke përfshirë këtu edhe kohëzgjatjen dhe periudhën në të cilën pastrimi i dhëmbëve është i domosdoshëm;
- 3- Vlerësimin e gjendjes së shëndetit dentar dhe oral të nxënësve të shkollave fillore në të gjitha qytetet e Kosovës, me një mostër prej 2900 nxënësve të ekzaminuar;
- 4- Vlerësimin e nivelit të edukimit për shëndetin oral të nxënësve të shkollave fillore, të mësimitdhënësve dhe të prindërve, në të gjitha qytetet e Kosovës;
- 5- Përgatitjen e rregullores-strategjisë afat shkurtër dhe afat mesme për edukim shëndetësor oral në Institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme të Kosovës, 2013-2018, ashtu siç parashihet në vendimin e Qeverisë së Kosovës, të aprovuar në mbledhjen e mbajtur me 30 mars 2010.

Neni 4 **Obligimet e palëve**

- 1-KISCOMS mban të drejtën e llogaritjes së shpenzimeve materiale që janë të domosdoshme për të realizuar projektin e përbashkët edukativ me MSH, si pjesë e kostos së projektit.
- 2-MSH në pajtim me mundësitë bugjetore mbështet projektin për edukimin shëndetësor të propozuar nga KISCOMS.
- 3-KISCOMS, njofton me shkrim MSH, për të gjitha të arriturat në kuadër të projektit.
- 4-KISCOMS, po ashtu, publikimin, prezantimin e rezultateve dhe të strategjisë për edukim shëndetësor oral në Institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme të Kosovës, 2013-2018, e bënë pranë Ministrisë së Shëndetësië.

Neni 5 **Kohëzgjatja e memorandumit të Bashkëpunimit**

- 1-Memorandumi i bashkëpunimit është vullnet i dy palëve për projektin e edukimit shëndetësor në përmirësimin e gjendjes së shëndetit dentar dhe oral në Institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme të Kosovës, që është i vlefshëm deri në realizimin e këtij projekti në Qershor 2013.
- 2- Memorandumi i bashkëpunimit në mes të dy palëve mund të plotësohet me shkrim dhe ndryshohet ndonjë fjali në rast nevojë, me pëlqimin dhe nënshkrimin e palëve.



Republika e Kosovës
Ministria e Shëndetësisë



Organization for Education, Science and Health
Organizata për Arsim, Shkencë dhe Shëndetësi


Neni 6 Gjuha e përdorur

- 1-Dokumenti i memorandumit të bashkëpunimit në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Organizatës për Arsim, Shkencë dhe Shëndetësi-KISCOMS, është shkruar në gjuhën shqipe.
- 2-Secila palë merr nga një kopje të Memorandumit të bashkëpunimit.


Neni 7

- 3-Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

Dr. Ferid Agani
Ministër i Shëndetësisë



Dr. Xheladin Ujkani
Drejtori Ekzekutiv



Nënshkruar në Prishtinë, me datë 06 Shkurt 2013